



Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes Komunës së Gjakovës dhe të Projektit ReLOaD3 (Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 3), që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), shpallim këtë:

FTESË PUBLIKE PËR OJQ-të

Sesion Informues

Thirrja e Parë Publike për Projekt Propozime për OSHC-të në Komunën e Gjakovës

Me datë 04 shkurt 2026 (e mërkure), me fillim nga ora 10:00, Komuna e Gjakovës, në bashkëpunim me UNDP-në dhe Programin Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3), organizon sesion informues dhe shpall Thirrjen e Parë Publike për dorëzimin e projekt-propozimeve nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të), në përputhje me kriteret dhe prioritetet e përcaktuara bashkërisht.

Thirrja do të jetë e hapur nga 04 shkurt deri më 17 mars 2026.

Në kuadër të thirrjes, përveç sesionit informues, gjatë dy ditëve 05 dhe 06 shkurt do të mbahet një trajnim mbi shkrimin e projekt-propozimeve, duke përfshirë: çfarë duhet të përmbajë një projekt-propozim, strukturën e tij, dhe elementët kryesorë të një projekti, bazuar mbi Ciklin e Menaxhimit të Projektit (PCM). Trajnimi do të zhvillohet në Sallën Solemne në pallatin e Kulturës "Asim Vokshi", duke filluar nga ora 10:00.

Paketa për aplikim, me të gjitha detajet, do të publikohet në faqen zyrtare të komunës pas përfundimit të sesionit informues.

Shënim: Për sesionet e Ciklit të Menaxhimit të Projektit (PCM), rekomandohet që OSHC-të të sjellin laptop-in personal, për lehtësimin e marrjes së shënimeve gjatë trajnimit.

Ju mirëpresim!